VENDIM
Nr. 216, datë 20.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË AXPO ALBANIA SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 115/3 prot., datë 12.12.2019, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë "AXPO Albania" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 7.11.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë "AXPO Albania" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "AXPO Albania" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 459/1 prot., datë 22.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, është kryer njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 32/49, datë 8.11.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "AXPO Albania" sh.a.

- Me shkresën nr. 459/2 prot., datë 12.11.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresat protokolluar në ERE me nr. 459/3 prot., datë 20.11.2019, dhe nr.459/4 prot., datë 2.12.2019, shoqëria "AXPO Albania" sh.a. ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Kjo shoqëri është regjistruar pranë QKB-së, në datën 22.4.2005, me statusin e shoqërisë aksionare (sh.a.), konform legjislacionit në fuqi dhe mban numër identifikimi (NUIS) K51628010V.

- Aplikimi i shoqërisë "AXPO Albania" sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", 'd") "e", është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "AXPO Albania" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti